

Jehona Rushidi - REXHEPI

PROJEKTIMI I PIKËPAMJEVE TË KONICËS NË TEKSTET E TIJ SI INTERTEKST

UDC 801.73:821.18

Abstrakt: *Krijimtaria letrare e Faik Konicës, imponon një lexim të veçantë. Është e dukshme që nevojitet leximi paralel i veprave dhe se mund të nënvijëzohet shënime eksplicite arkitekstuale dhe elemente autobiografike. Gjithashtu, vërehet që pos orientimit në situatën personale të krijuesit, e njëjta krijimtari jep disa modele të teknikave intertekstuale. Prandaj, ky punim mendohet të jetë sintezë e një leximi të vëmendshëm dhe e zbatimit praktik të teorisë së citatshmërisë dhe teorisë së intertekstualitetit. Lidhur me këto teori, në krijimtarinë letrare të Konicës, përpos arkitektit, bie në sy edhe vënia e letrave në tekst që mund të shqyrtohet si prani e tekstit në tekst, tekstit të dytë brenda tekstit të parë kornizë dhe si citat i rremë. Pos shkrimeve tjera, “Shqipëria si m’u duk” jep mundësi për ta përkufizuar si çelës të zbulimit të preokupimeve, filozofisë, dilemave dhe botëkuptimeve të Faikut dhe personazhëve të veprave të tij. Meqë domethënia e veprës bëhet e plotë me referim në dy vepra tjera të po të njëjtit autor, mund të thuhet që nga terminologjia intertekstuale duhet të definohet si brikolazh. Përshtypjet e Konicës për Shqipërinë janë si përshtypjet e personazhëve të krijimeve prozaike të shkrimtarit. Duke i përgjithësuar raportet tjera intertekstuale, punimi do të ilustrojë edhe shembuj të formave të hipertekstualitetit dhe autocitateve.*

Fjalët kyçe: *Faik Konica, elemente autobiografike, citatshmëria, intertekstualiteti*

Hyrje

Teoria e intertekstualitetit e shtron veprën letrare si krijim që asnjëherë nuk krijohet nga hiç-i. Brumi parësor apo kahja e dialogëzimit janë të ndryshme por të patjetërsueshme. Qoftë në formë latente, pjesërisht apo krejtësisht të dukshme, hipotekstet funksionojnë aq gjatë sa edhe ekziston vetë letërsia. Shtytja për të punuar në këtë problematikë gjithashtu qëndron edhe në dokumentimin dhe të vërtetuarit se kjo teori mund të aplikohet në krijime të periudhave të ndryshme letrare dhe jo vetëm postmoderne (meqë vetë teoria lidhet me këtë fazë).

Për ta konkretizuar nismën le të themi se: “Dr Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, “Katër përralla nga Zullullandi” dhe vepra e titulluar “Shqipëria si m’u duk”, imponojnë një lexim të veçantë. Dr. Gjëlpera dhe Zullullandi, receptohen si dy sinjale të figurshme dhe jo krejtësisht eksplicite. Duke u kthyer së pari në njërin nga titujt (*Katër përralla nga Zullullandi*) vërehet që në titull shënimi arkitekstual-*përralla* që ndërlidhet me shkrimin në prozë, si formë e shkurtër dhe themelore. D.m.th. një formë shkrimi që i praprin novelës dhe romanit, por që pason shkrimin epik në vargje. Te Konica, raporti tekst letrar-aktualitet politik shpie padiktueshëm dhe në të njëjtën kohë detyrimisht në vështrimin e një relacioni më të ngushtë të tekstit dhe pikëpamjeve të autorit. Gjatë leximit, vërejmë që pos orientimit në situatën personale të krijuesit, e njëjta vepër jep disa modele të teknikave intertekstuale.

Katër përralla nga Zullullandi

Figurshmëria e tekstit dhe nevoja e lexuesit të përgatitur, ndeshet që në fillim. Pjesa e parë e veprës titullohet “Një ambasadë e Zulluve në Paris”. Hapësirat e zhvillimit të veprimtarive diplomatike për Faik Konicën nuk janë aspak të panjohura edhe para angazhimit të tij në Uashington, gjegjësisht, ai i frekuenton këto qarqe edhe më herët. Fillimi i rrëfimit zgjon shenjat e para të dyshimit për praninë e kuptimit të dytë, një udhëheqës, sundues, të cilin ndoshta vetëdija e lexuesit e lidh me Zogun:

Rrota e Fatit, e cila bëri të lirë aq popuj që nuk e meritonin, u zgjoi edhe zulluve oreksin për vetëqeverim. Dhe ashtu, një ditë vere, na zbriti në Paris një negër, i ngarkuar nga bashkëvendasit me misionin që të punojë për larinë e Zullullandit (Konica, 2002, f.9).

Kështu ilustron figura e Denizullu-Serpës, me të cilin, sa herë që diplomatët mërzhiten, zbavitën duke e tallur, përderisa ai shkruan raporte mbi sukseset e tij. Këto raporte në vepër gjehen grafikisht të ndara nga pjesa tjetër e tekstit. Teksti jepet në frëngjisht dhe objekt i talljes veç tjerash bëhet njohja e dobët e gjuhës frenge. Sa i përket teknikave intertekstuale, vënia e letrave në tekst mund të shqyrtohet si prani e *tekstit në tekst*, tekstit të dytë brenda tekstit të parë kornizë dhe njëherit si *citata të rrejshme*. Kur flasim mbi letrat që vendosen brenda tekstit, le të ilustrojmë edhe shembullin:

Zotëri

Kemi të dhëna që ju jeni një kritik i zoti, i zgjedhur e i shkolluar, ndonëse i panjohur, si dhe një studiues i apasionuar i Uolter Pejterit. Ne kemi bërë plan që pas njëfarë kohe, të bëjmë një botim kritik të veprave të plota të eseistit të madh Anglez. Mund ta merrni, në konsideratë, ofertën tonë për t'u marrë me një botim të tillë? Duke pritur me padurim një përgjigje, mbetemi sinqerisht tuajët, zotëri,

Murray dhe Co

Denizullu-Serpet, Esh. (Konica, 2002, f.12).

Përkrah këtij tipi të personazhit, vepra ilustron edhe njeriun i cili:

I stërvitur në një kolegji protestant në Cape-Town, kish mësuar letrat e bukura klasike dhe moderne, kish udhëtuar në Evropë, dhe, autodidakt i palodhur, e quante veten student dhe këndonte përditë libra të thellë, sado që kish arrijtur në prag të pleqërisë me një kulture të rrallë (Konica, 2002, f.15).

Ky personazh, Plugu, mbështet filozofinë se vetëm gjysmë të diturit kanë mbaruar mësimet dhe në një mënyrë shumë direkte na ndërlihd në një personazh që shumë i afrohet formimit, shijes dhe ideve të Konicës. Megjithatë, sërish mbetet pa fjalë përpara vetëbesimit të personazhit të parë. Për mbretin e Abisinisë shkruajnë letra Plugu dhe Zgjobua. Populli vendos që më e mira është e dyta, një shkrim me italishte qesharake, i vlerësuar nga njerëz që se njohin aspak italishten. Atëherë pason pyetja ironike e Plugut:

Teksti i z. Zgjobo ju pëlqeu. Po thomëni, ju lutem, sa prej jush dine italisht? Dhe nga ata që mund të dinë pak, kush është i zoti të zgjedhë cili tekst është më i miri? (Konica, 2002, f.23).

Ky portertizim, gjithashtu, është pjesë e identifikimit të figurës së Konicës. Por, momenti kur Plugut i kujtohen fjalët e Hamletit rreth vdekjes të cilën e kupton si gjumë, hap më thellë qëndrimin filozofik të tij. Dilema hamletiane është edhe dilema e Plugut, e Konicës gjithashtu. Plugu vendos të ikë, aq i dëshpruar nga vendi që vizitoi, sa që dëshiron të shkojë në kontinent tjetër.

Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit

Vepra e dytë, në të cilën përsëri kemi të përfshirë një shënim arkitekstual është vepra “Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit-përrallë”. Leximin nuk e kënaq vetëm përkufizimi i llojit të prozës. Leximin e plotëson, si më sipër, edhe natyra e përrallës, si një nga format e shkurtëra themelore, formë në të cilën thurren fiktivja me realen në një mënyrë që nuk vërehet i qartë kalimi nga njëra hapësirë në tjetrën. Prandaj, mund të përsërisim që *përralla* është një shënim që nuk lejon implicitetin dhe orienton tipin e lexuesit të përgatitur.

Edhe në qëndrimet rreth veprës thuhet që portretizimi i Dr. Gjëlperës, që është njëkohësisht moral, shpirtëror e ditunor përballë ambientit shqiptar të viteve të njëzeta, është një shprehje e qëndrimeve dhe ideve të Konicës ndaj fenomeneve të kësaj hapësire ndërsa portretizimi intelektual i personazhit shihet si i lidhur me veçantitë e vetë autorit (Hamiti,2002).

Dr.Gjëlpera është intelektual i formuar në qendra të njohura, adhures i letrave, që vendos të bëhet mjek për të përmbushur dëshirën e të jatit. Idetë e tij ngjasojnë me të Hamletit, ai lexon klasikët, dëgjon Bethovenin, Shopenin, shikon me ëndje operën dhe me Verën diskuton mbi letërsinë dhe artin, njeh Rusinë. Udhëton për Suedi dhe krahason vëndet dhe aty ndesh Ingridën, që *s’kërkon një Romeo*.

Deri këtu, gjatë leximit së paku ndeshim dy teknika, citatin: *çdo gjë me masë fjalë e vërtetësisë klasike* - që del si citat i vërtetë i shenjzuar; pastaj Romeon, sinjal për epitetin që nënkupton dashurinë e pasionuar, sipas figurës së njohur shekspiriane.

Më pas, heroin e veprës e gjejmë si të diplomuar i cili vazhdon ende kontaktet me Ingridën, derisa nuk dëgjohej në Suedi lajmet rreth Kongresit të Lushnjës dhe Kryengritjes së Vlorës. Duke u referuar në Sokratin dhe Gëten, të cilët mençurinë e tyre e shesin në vendlindje, Dr. Gjëlpera kujton Shqipërinë. Niset nga Upsala, mbërrin në Itali, mahnitet nga Firenca, por:

...treni që e shpinte nga Roma në Bari, ia ktheu mendimet te qëllimi i madh i udhëtimit të tij. Dhe kur anija e vogël me avull mbloodhi hekurin dhe bëri për zallet e Shqipërisë, ndien në zemër një shtrëngim si të një njeriu që mbyll një pjesë të librit të jetës së tij dhe hap një pjesë të re, ku s’di se ç’ka për të shkruar dora e fshehtë e Fatit (Konica, 2007, f. 244).

Dëshprimi i parë vjen nga zbritja në portin e Durrësit, doganierët, rryshfeti, kafenetë, tymi, kumarxhinjtë, dr. Emrullahu, Salemoza. Dr. Gjëlpera bie në kundërshtim me metodat e shërimit të dr. Emrullahut dhe ende ka bindje se mund të dëshmojë që koha e magjive ka përfunduar dhe se është një kohë e re e kuptimit, e shkencës.

Pjesa e katërt e veprës, e zhvendos heroin në Tiranë. Mendimet e tij përpunojnë edhe shijen e Oskar Uajldit, ndërsa ironia e Dr.Gjëlperës theksohet veçanërisht kur shtiret në momentin që kupton se Protagoras Dhalla nuk qenka Protagora, bashkëkohasi i Sokratit. Fundi i veprës përcillet nga viti i shkrimit, 1924. Lidhur me motivin e veprës, një vit më herët, më 1923 ndodh vrasja e të huajve në Mamurras, që supozohet ta ketë shtyrë autorin ta shkruajë veprën.

Lidhur me emërimin e Faik Konicës si ministër i Shqipërisë në Uashington, kemi të dhëna për një pasqyrë e mbrojtësve të Faikut rreth afërsisë së tij me Zogun:

Kryediplomati amerikan në Tiranë, Charles Hart (Çarlz Hart), mendonte se patriotizmi dhe jo paraja duhet të ishte arsyeja kryesore që Faiku kishte pranuar ofertën e Zogut (Ikonomi, 2011, f.11).

Nga ana tjetër, i gjejmë të parashtruara edhe mendimet e atyre që urrenin Faikun:

Thoshin se besonte në përmbysjen me dhunë të pushtetit siç ishte shprehur botërisht në Dielli kur kishte mbështetur revolucionin e Nolit në qershor 1924, çka, sipas këtyre armiqve të tij shpesh binte ndesh edhe me kushtetutën amerikan (Ikonomi, 2011, f.11).

Faik Konica paraqitet si njeri, i cili është i ditur dhe i interesuar në veçanti për fushat e ndryshme të artit por edhe për historinë, modën, gatimin. Duke llogaritur në shkollimin e tij në qendra si Turqia, Harvardi, Franca, Amerika, thuhet që fliste një frengjishte dhe anglishte mjaft të pasur. Diskutimet që janë shtruar shumë shpesh lidhur me momentet jetësore të Faikut, janë ato lidhur me raportet e tij me Zogun, sidomos kur dihet sa i afërt është me Nolin dhe sa në kundërshtim është vetë Noli me Zogun. Për këto raporte, që janë shpesh kontradiktore thuhet se të dy e donin fort muzikën dhe se nga koncertet klasike që jepnin dy orkestrat simfonike me famë të Vjenës, nuk lanë pa dëgjuar ndonjë prej tyre (Ikonomi, 2011).

Në njërën nga shkrimet e Faikut në “Dielli”, vetë ai jep sqarime rreth përfundimit të veprës “Dr. Gjëlpera...” duke u arsyetuar se të shkruarit e një libri të vërtetë kërkon një qetësi që ai nuk e ka, për çka shprehet:

Jam duke shkruar nëpër një krizë të shpirtit, e cila më pengon nga çdo vepër ku duhen krahe të lira për fantazinë e shkrimtarit (Ikonomi, 2011, f. 33).

Këtu lind dilema nëse Faik Konica vërtet ka krizë shpirtërore ose pranimi i emërimit në Uashington, postit të ri dhe ngjarjet që ndodhin në fund të vitit 1924, e bëjnë që të tërhiqet nga shkrimi që interpretohej si satirë kundër Zogut.

Këto të dhëna shpiejnë sërish te Plug-u dhe Dr. Gjëlpera, dy personazhët që shpesh mbeten të pakuptuar, janë kritikë dhe janë të interesuar për vetëdijësimin, në rastin e parë të zulluve, një populli që ka ambicje por të koklavitur dhe të paqartë dhe në rastin e dytë si një shqiptar të formuar perëndimor, që sheh kapacitetet e pashfrytëzuara të vendit dhe ato të stërzmadhuara evropiane.

“Shqipëria si m’u duk”, jep mundësi për ta përkufizuar si çelës të zbulimit të preokupimeve, filozofisë, dilemave dhe botëkuptimeve të Faikut dhe personazhëve të veprave të tij. Meqë domethënia e veprës bëhet e plotë me referim në dy veprat e mësipërme të të njëjtit autor, mund të thuhet që nga terminologjia intertekstuale duhet të definohet si *brikolazh*. Përshtypjet e Konicës për Shqipërinë janë si përshtypjet e personazhëve që u përmendën më sipër.

Përfundimi

Studiuesi që mbështetet në teorinë e intertekstualitetit insiston në dekodimin e tekstit të mbindërtuar. Duke dalluar pjesët e materialit të ri tekstual, dialogun që hapin ato, mënyrat e inkorporimit dhe kombinimit të tyre, paraqitet si i domosdoshëm përdorimi i tipologjive dhe derivateve të termit intertekstualitet.

Të shoqëruarit e shembujve nga krijimtaria e Konicës me tipologjitë, parametrat, termat që dalin nga teoria e intertekstualitetit nënvijëzojnë faktin se praktika intertekstuale është domosdoshmëri spontane, e vetëdijshme apo e pavetëdijshme e autorit dhe rrjedhimisht e tekstit dhe e kulturës së lexuesit. Hipotekstet, hipertekstualiteti, citatet e rrejshme, sinjalet eksplicite dhe implicite, dukuria e tekstit në tekst, brikolazhi, për Konicën janë teknika të pavetëdijshme por të natyrshme. Studiuesi bashkëkohor i krijimtarisë së Konicës mund të bëjë analizë të ngjashme me atë që i bëhet letërsisë në të cilën në të shumtën e rasteve krijuesit të vetëdijshëm i përdorin këto teknika.

Pikërisht siç shprehen edhe themeluesit e kësaj teorie, mes së cilëve Zheneti dhe J. Kristeva, e pamundur është që teksti të jetë skajshmërisht i pastër. Aty ku kryqëzohen se paku dy rrafshë, aty lind një tekst i ri. Duke e përmbyllur këtë punim, detyrimisht duhet përmendur që në hulumtimet bashkëkohore të letërsisë shqiptare ndihet nevoja për këto lloj qasjeje, këndvështrime dhe analiza të cilat do t’i bashkonin: teorinë intertekstuale, atë të citatshmërisë dhe atë të recepcionit.

Bibliografia

- Hamiti S. 2002. *Letërsia Moderne*, Faik Konica, Prishtinë, f. 108.
- Ikonomi I. 2011. *Faik Konica-jeta në Uashington*, Onufri, f. 11-33.
- Konica F. 2002. *Katër përrallat nga Zullullandi, në Shqipëria-Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Album, Tetovë, f.9-23.
- Konica F. 2007. *Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit*, në *Vepra*, Konica, Tiranë, f.244.
- Konica F. 2007. *Vepra*, Konica, Tiranë.